



**Republika e Kosovës**  
**Republic of Kosova**



**Komuna Hani i Elezit**  
**Municipality of Hani Elezit**

## **ZYRA LIGJORE**

### **Plani i punës për periudhën: Janar- Dhjetor për vitin vijues 2011**

Zyra Ligjore në Komunën e Hanit të Elezit do të punoj ngusht me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe do të jetë në kordinim duke respektuar Ligjin për vetqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me nr.03/L-040, i cili është bazë për vetqeverisje të Komunave, gjithashtu edhe në respektimin e akteve nënligjore të kësaj ministrie që nxirren për të zbatuar Ligjet në Fuqi dhe në Kompetencë komunale. Gjithashtu do të kemi edhe bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike ( bashkëpunimi i rrespektimit dhe impelmentimit të Ligjit për Shërbyesit Civil, Ligji mbi Pagat e shërbyesve civil, Ligji i Punës, që janë Ligje që do të gjenjnë implementim gjatë vitit 2011 për shkak se janë ligje aktuale, bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me ministri të tjera të Republikës së Kosovës.

Gjatë këtij viti Zyra Ligjore në kuadër të Adminsitratës së Komunës së Hanit të Elezit dhe nën përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës do të mundohet që të punoj sipas planit dhe detyrave nën përgjegjsinë e kësaj zyre.

Gjatë vitit 2011 do të përgjigjemi të gjitha kërkesave që do të jenë në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës në afat të caktuar kohor, do të hartojmë vendimet në kuadër të zyrës së Kryetarit, do të hartojmë përgjigjet e të gjitha ankesave që do të kemi, zgjidheje të lëndëve, hartimin e autorizimeve, vërtetime dhe punë të tjera të cilat janë në kompetencën tonë. Me zyrën e personelit do të punojmë në bazë të udhëzimeve të bëra nga ana e Ministrisë së Administratës Publike që në Komunë të ketë discipline për të gjithë punëtorët e Komunës dhe do ta shpërndajmë te të gjithë punëtorët edhe kodin etik dhe të mirësjelljes.

Në bashkëpunimë me të gjitha Drejtoritë komunale do të bashkëpunojmë në hartimin e rregulloreve komunale të cilat do të jenë në plan të Kuvendit të Komunës, shqyrtimin e tyre në punë në grupe, shqyrtimet publike dhe paraqitjen e tyre për Miratim pranë Kuvendit të Komunës. Do të shqyrtojmë të gjitha detyrimet që janë për komuna në nxjerrjen e rregulloreve komunale të obligueshme. Mirëpo ne si Komunë e re do të marrim shembullin edhe nga Komunitatet e tjera në hartimin e këtyre rregulloreve dhe pas diskutimeve do të specifikojmë rregulloret që komuna jonë më një afat më të shpejt t'i miratoj.

Do të bashkëpunojmë ngushtë me Drejtoritë e Komunës tonë në mënyrë që të mundemi që të bëjmë punët në bazë të rregullave dhe akteve juridike në fuqi.

Gjatë vitit 2011 do të marrim pjesë në seancat gjyqësore që do të zhvillohen si në Gjykatën Komunale ashtu edhe në Gjykata të tjera. Gjatë vitit 2011 në Gjykatën Komunale në Kaçanik do të bëjë përfaqësimin në të gjitha lëndët të cilat do të jenë në Kompetencën tonë.

Do të Konsultohemi dhe do të jemi në kontakt me Gjykatën Kushtetuese për kërkesën e Emrit të Komunës sonë në gjuhë serbe që e kemi hartuar dhe deponuar në këtë Gjykatë vitin e kaluar.

Do të fillojmë hartimin, mledhjen e materialit dhe ngritjen e padisë për Agjensionin e Kosovës për Privatizim AKP-në pas vendimit të marrë në Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit në janar të 2011, për shkak të mosrespektimit të procedurave ligjore në fuqi dhe anashkalimin e organeve Komunale për privatizimin e fabrikës për prodhimin e Cimentos “Sharr Cem”.

Gjatë vitit 2011 do të përcjellim të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbledhjet e Kuvendit të Komunës, Komiteteve të tjera të themeluara në Komunë dhe do të mundohemi që të kontribuojmë në fushën e kompetencave të tyre në bazë të Statutit, Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Udhëzimeve Administrative të nivelit Qendror.